

ROLE OF KOSOVO SECURITY FORCE IN EMERGENCY MANAGEMENT

Enver Gërguri

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, enveri@hotmail.com

Habib Basholli

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, habib.basholli@gmail.com

Abstract: This paper provides data that show the role of the Kosovo Security Force in Emergency Management. Assessing the problems that arise from this topic, the paper intended to present the role of emergency management within the KSF as an organization.

This paper attempts to address the issues arising from the KSF's emergency management.

The data presented in this paper orient us correctly and accurately based on the legislation in force on how the Kosovo Security Force manages emergency management and what its role is.

At the beginning, this paper presents the mission and management of emergencies in accordance with applicable laws and regulations, as well as the ways of organizing emergency operations and the role that the Kosovo Security Force has in managing Situations in the Republic of Kosovo.

From this paper it can be understood that the Kosovo Security Force, based on the legislation in force, plays a key role in organizing and conducting emergency operations in the country by supporting all other security institutions operating in Kosovo.

Keywords: Organization, KSF Role, Emergency Situation Management

ROLI I FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS NË MENAXHIMIN EMERGJENCIVE

Enver Gërguri

Kolegji BIZNESI Prishtinë, Kosovo, enveri@hotmail.com

Habib Basholli

Kolegji BIZNESI Prishtinë, Kosovo, habib.basholli@gmail.com

Abstrakti: Ky punim siguron të dhëna të cilat tregojnë në lidhje me rolin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Menaxhimin e emergjencave. Duke vlerësuar problematikat që lindin nga kjo temë, une kam synuar që të paraqes rolin në menaxhimin e situatave emergjente brenda FSK si një organizatë.

Në këtë punim jam përpjekur që të shtrojë problematikat që vijnë nga mënyrat e menaxhimit të emergjencave nga FSK-ja.

Të dhënat e paraqitura në këtë punim na orjentojnë drejt dhe saktë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi se si Forca e Sigurisë së Kosovës bënë menaxhimin e emrgjencave dhe cili është roli i sajë.

Në fillim të këtij punimi kam parqitur misionin dhe menaxhimin e emergjencave konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, poashtu kam paraqitur mënyrat e organizimit të operacioneve emergjente si dhe rolin që ka Forca e Sigurisë së Kosovës në menaxhimin e Situatave në Republikën e Kosovës.

Nga ky punim mund të kuptohet se si Forca e Sigurisë së Kosovës duke u bazuar në legjislacionin në fuqi merr rolin kryesor në organizimin dhe zhvillimin e operacioneve emergjente në vend duke pasur mëshitetje të gjitha institucionet tjera të sigurisë të cilat veprojnë në Kosovë.

Fjalë kyçe : Organizata , Roli i FSK-së , menaxhimi i situatave emergjente etj.

1. HYRJE

Objektivi kryesor i këtij punimi është Roli i Forcave të Sigurisë së Kosovës në Operacionet e Emergjencave. FSK si instrumenti i sigurisë, me misionin e vet ka për qëllim tëmbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe t'iu ndihmojë autoriteteve civile ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave tjera.

Menaxhimi i Emergjencave dhe Mbrojtja Civile janë elementët bazë për mbrojtjen e jetës jo vetëm për të gjithë qytetarët, por për të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë njerëzore përfshirë edhe mjedisin. Përkufizimi i menaxhimit të emergjencave mund të jetë jashtëzakonisht i gjerë. Por, “menaxhimi i emergjencave është një disiplinë e cila merret me rrezikun dhe shmangien e rrezikut. Ky përkufizim dëshmon se menaxhimi i emergjencave është pjesë integrale e sigurisë së jetës së përditshme të të gjithëve.

Në vendet e Bashkimit Evropian fondet për qëllimin e menaxhimit të emergjencave janë në rritje në kuptimin e miliona eurove dhe po këto hapa janë duke u ndjekur edhe nga vendet kandidate për në BE, por sidomos ato vende

fqinje me BE-në ku synon të hyjë edhe Kosova.Republika e Kosovës, si vend në zhvillim e sipër, ka nevojë për kapacitete më të përgatitura për të qenë në gjendje të reagojë në situatë krizash e që mund të jenë të natyrës së ndryshme.

Emergjencat përbëjnë situatë serioze ,të papritur dhe zakonisht të rrezikshme që kërkon veprim të menjëhershëm. Me emergjencat potencialisht mundtë përballet dhe është i rrezikuar çdo vend, pavarësisht pozitës gjeografike. Çdo shtet duhet t'i jep prioritet fushës së emergjencave,duke pasur parasysh se parandalimi në të shumtën e rasteve rezulton në zvogëlimin e fatkeqësive. Përveç kuadrit ligjor ,prioritet në këtë rast dotë duhejt'i jepet edhe shtimit të kapaciteteve njerëzore dhe teknike.

Kosova nuk bën përjashtim në këtë dimension të rregullimit me strategji dhe ligj e të kësaj problematike . Me një kuadër të konsoliduar ligjor , institucionet përgjegjëse kanë nxjerrë edhe dy strategji lidhur me situatat emergjente , e që përfshihen në: “Sistemi i Integruar i Reagimit ndaj Emergjencave”dhe “Planii Reagimit Kombëtar”.Veç rregullimit në nivel kombëtar,disa komuna kanë hartuar edhe plane komunale të reagimit ndaj emergjencave të ndryshme , plane komunale të operacioneve emergjente këto që sipas PRK¹¹⁰, komunitat i aktivizojnë sipas nevojës . Jo rrallëherë , komuna të ndryshme të Kosovës , janë përballë me situatë emergjente, nga të cilat kanë humbur jetë njerëzish dhe janë dëmtuar prona e paluajtshmëri . Zinxhiri i komunikimit në raste emergjencash , sipas strategjive dhe ligjeve në fuqi ,jo rrallë herë ka patur ndikimin e tij negativ. Ky zingjir poshtë-lart, i komunikimit , është aq kompleks,sa ndikon edhe në kohën e reagimit ndaj emergjencave.

Forcat e Sigurisë së Kosovës , Agjensioni i Menaxhimit të Emergjencave , Komunitat me njësitë e zjarrfikjes ,kryqi i kuq , policia ,shërbimi informativ i shtetit; strukturat e kërkim-shpëtimit etj., janë një nga elementët më të rëndësishëm të sistemit të sigurisë së vendit, ose mund të thuhet se përbëjnë boshtin e kësaj sigurie, pasi në misionin e tyre këto lloje strukturash e kanë edhe misionin e tyre parësor, por që gjithnjë në përbërje të këtij misioni do të evidentohet se janë pjesë përbërëse me vend dhe rol të veçantë në forcat e emergjencave.¹¹¹

2. MISIONIN E FSK-SË NË MENAXHIMIN E OPERACIONEVE TË EMERGJENCAVE

Pas shpalljes së Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, Kosova, ka krijuar institucione të reja, duke përfshirë këtu edhe Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës , respektivisht Ministrinë e Mbrojtjes nga data 14.12.2018 (MM) dhe Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK).Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, bashkë me të, edhe Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, Ligji i Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe Ligji mbi Shërbimin në Forcën e Sigurisë të Kosovës , amandamentimi i këtyre ligjeve është bërë me datë 14.12.2018, gjë që FSK merr si mision primar mbrojtjen dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 126 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës do të shërbejë si forcë e Sigurisë Kombëtare për Republikën e Kosovës, si dhe mund t'i dërgojë pjesëtarët e vetë jashtë vendit, në pajtim të plotë me përgjegjësitë e veta ndërkombëtare. Forca e Sigurisë së Kosovës do t'i mbrojë njerëzit dhe komunitetet e Republikës së Kosovës, bazuar në kompetencat që ia siguron ligji. Kryetari i Republikës së Kosovës është Komandant Suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës.¹¹²

3. MENAXHIMI I OPERACIONEVE EMERGJENTE NGA FSK KONFORM LEGJISLACIONIT

Vërshimet e vitit 2005 ,zjarret e vitit 2007,si dhe incidenti me vajin disulfurik i vitit 2008, kanë potencuar nevojën e përqendrimit në përmirësimin e menaxhimit emergjent, kapacitete vetë reagimit ndaj incidenteve dhe proceseve koordinuesenë tërë vendin . Çasja gjithëpërfshirëse kombëtare e aplikueshme në të gjitha nivelet juridiksionale dhe në të gjitha disiplinat funksionale , përmirëson efektivitetin e personelit të menaxhimit/reagimit emergjent , në tërë spektrin e incidenteve të mundshme dhe skenareve të rrezikshme, përfshirë fatkeqësitë natyrore , aktivitetet terroriste dhe fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga faktori njeri .Çasja e tillë përmirëson koordinimin dhe bashkëpunimin midis agjencive/organizatave publike dhe private në aktivitetet e ndryshme të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve . Korniza e *Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME)* e avancoi çasjen gjithëpërfshirëse kombëtare.

Edhe pse incidentet zakonisht fillojnë dhe përfundojnë në rrafshin lokal dhe menaxhohen mbi baza ditore në nivelin më të ulët të mundshëm gjeografik, organizativ dhe juridiksional , prap se prap, ekzistojnë rrethana në të cilat operacionet e suksesshme të menaxhimit të incidentit varen nga përfshirja e shumë juridiksioneve , niveleve të qeverisjes , agjencive funksionale dhe disiplinave të shumta të reagimit emergjent . Këto rrethana kërkojnë koordinim efektiv dhe efikas midis këtij spektri të gjerët strukturave dhe aktiviteteve.

¹¹⁰ Qeveria e Kosovës, Plani i Reagimit Kombëtar, Prishtinë, dhjetor 2010, shtojca4,pika2,f. 70

¹¹¹ Lama, Kudusi, Analiza dhe vlerësimi i rrezikut / Mungesa e strategjive dhe burimeve financiare, rrezik i vazhdueshëm për fatkeqësi që përbëjnë emergjencë, Kolegji “Biznesi”, Prishtinë 2013.

¹¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 126, Forca e Sigurisë së Kosovës, f. 51

Sistemin i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave përdor çasje sistematike për integrimin e procesve dhe metodave më të mira ekzistuese, në kornizën e unifikuar kombëtare për menaxhimin e incidenteve. Menaxhimi i incidenteve i referohet mënyrës se si menaxhohen incidentet përgjatë të gjitha aktiviteteve të sigurisë kombëtare, përfshirë parandalimin, mbrojtjen, reagimin dhe rimëkëmbjen. Kjo kornizë krijon bazat për ndërveprim dhe përputhje të cilat në kthim mundësojnë që organizatat e ndryshme publike dhe private të kryejnë operacione të integruara mire dhe efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.

Menaxhimi emergjent është integrimi dhe koordinimi i të gjitha aktiviteteve të nevojshme për ngritjen, mbajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve për tu përgatitur, mbrojtur, për të reaguara për të rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore të mundshme apo aktuale, aktete terrorizmit apo fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga faktori njeri. Këtë e bënë përmes koncepteve, parimeve, procedurave, proceseve organizative, terminologjisë dhe kërkesave standard të aplikueshme për komunitetin e gjerë të shfrytëzuesve të sistemit.

Të gjithë Institucionet e Republikës së Kosovës në nivel qendrorë dhe local do të jenë përgjegjëse për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave. Grupi drejtues për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave është krijuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Forca e Sigurisë së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit, Qendrës së Situatave, Sekretariatit të Sigurisë Kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare.¹¹³

4. KORNIZA LIGJORE PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE

Zbatimi i ligjeve për ekonominë dhe ligjeve për emergjencat është sfidë për institucionet larta të vendit dhe ato të emergjencave. Sepse, në asnjë fushë të veprimtarisë së shoqërisë, por në veçanti në kushtet e përgatitjes për emergjencë dhe të emergjencës, zbatimi me rreptësi i ligjit është kusht bazë i suksesit dhe se çdo shmangie nga ligji ose moszbatim i tij shoqërohet me shumë jetë njerëzore të humbura e me dëme të pa llogarishme ekonomike.¹¹⁴

Të gjitha institucionet relevante të Republikës së Kosovës që ndërveprojnë dhe veprojnë së bashku në menaxhimin e emergjencave, iu referohen akteve të ndryshme ligjore për të ndarë përgjegjësitë dhe për të bashkëpunuar në tejkalimin e këtyre rasteve. Aktet ligjore të cilat ndër të tjera rregullojnë këto çështje, janë:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligji për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi tjera Nr.2006/02/L-68; Ligji nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri; Ligji Nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Ligji nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; Ligji për Menaxhimin e Financave Ligji për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L045; Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës; Ligji nr. 04/L-076 për Policinë; Ligji për Telekomunikacionin Nr.2002/7; Ligji për Transportin rrugor Nr. 2004/1; Ligji për Shendetësi Publike Nr. 02/L-78; Ligji për Kujdesin Shendetësor Emergjent Nr.2006/02-L50; Ligji për Kryqin e Kuq të Kosovës Nr.03/L-179; Ligji për PlotësimNdryshimin e Kodit Penal të Kosovës Nr.2008/03-L-002; Ligji për Plotësimndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës Nr.2008/03-L-002; Ligji për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006; Ligji për Procedurën Jokontestimore Nr.03/L-007; Ligji për Ndërrmarjet Publike Nr.2008/03-L087; Ligji për vetëqeverisjelokale Nr.2008/03-L040; Udhëzim Administrativ për kriteret themelimit dhe organizimit të shërbimit zjarrfikës dhe shpëtimit në Kosovë Nr.05/2007; Udhëzim Administrativ për metodologjin e hartimit të vlerësimit të rrezikut dhe planeve për mbrojtje dhe shpëtim Nr.19.2008; Udhëzim Administrativ për themelimin e këshillit për sigurinë në komunikacion, nr. 18/2008; Rregullorja e punës së Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Rregullorja për punën e Qendrës së Situatave.

5. LEGJISLACIONI PËR MENAXHIMIN E OPERACIONEVE TË EMERGJENCAVE DHE FSK

Në Ligjin Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ndër të tjera në nenin 2, paragrafi 2.3, për kompetencat e këshillit parashihet: “Këshilli i Sigurisë së Kosovës shqyrton planin qeverisës dhe jetëvjeçar për Forcën e Sigurisë së Kosovës para se ai të miratohet nga Qeveria dhe pastaj t’i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar.”¹¹⁵ Gjithashtu në këtë ligj si anëtar të përhershëm të Këshillit të Sigurisë janë ministri i FSK-së dhe komandanti i FSK-së.¹¹⁶

“15.1 Gjatë kohës së gjendjes së shpallur të emergjencës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe Ministri i Qeverisë, në të cilët duhet të bartet pushteti ekzekutiv. Nëse ndonjëri nga ministrat nuk është në gjendje të marrë pjesë, në mungesëtë tij duhet t’ilejohet pjesëmarrja zëvendësministrit.

¹¹³ Qeveria e Kosovës, Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë, maj 2010, f. 3-4.

¹¹⁴ Lama, Kudus, Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve/ Rëndësia që ka zbatimi i ligjshmërisë për operacione të sigurta emergjence, Ligjërata të autorizuara, Kolegji “Biznesi”, Prishtinë, 2013

¹¹⁵ Republika e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, f. 2

¹¹⁶ Po aty, f. 3.

15.2 Këshilli i Sigurisë së Kosovës do të përfshijë këta anëtarë në cilësi këshillëdhënëse:

*Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Siguri; Këshilltarin e lartë për siguri të Presidentit; Këshilltarin e Kryeministrit për Siguri, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës; Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Sekretarin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Drejtorin e departamentit për menaxhimin e emergjencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.*¹¹⁷

Në Ligjin nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, Neni 70, parasheh zbatimin e detyrave.

6. DETYRAT ZBATOHEJEN NGA:

*Njësit, shërbimet dhe strukturat operative të shoqatave dhe organizatave tjera jo qeveritare; Organizatat dhe institucionet; Njësit dhe ekipet e reagimit emergjent; Policia e Kosovës; Forca e Sigurisë së Kosovës.*¹¹⁸

Pra, në këtë nen përcaktohet qartë se një shtyllë kryesore në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera është FSK-ja.

Ndërsa, në nenin 75 për Mbrojtjen nga Mjetet e Pashpërthyer, ekskluzivisht mbetet një detyrë e FSK-së, realizimi i demontimit të këtyre mjeteve:

7. OPERACIONET QË KËRKOJNË ANGAZHIMIN E FSK SI FORCË KRYESORE OSE NDIHMËSE

Në Ligjin nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në nenin 10 *Misionet dhe detyrat*, parashihet:

10.1 Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë, është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës.

10.2 Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë apo kapacitete sulmuese ajrore. Çdo ndryshim në armatim do të përcaktohet nga Prania Ushtarake Ndërkombëtare, në bashkërendim me Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vite nga koha e hyrjes në fuqi e këtij Ligji. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

- Të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes.
- Të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera.
- Të kryejë shkatërrimin e mjeteve shpërthyes si dhe të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile.¹¹⁹

Pra me këtë Ligj, parashihen qartë angazhimet e FSK-së si forcë kryesore apo ndihmëse në operacione të ndryshme.

8. NEVOJAT E FSK PËR BASHKËPUNIM NË SITUATA EMERGJENCE DHE MËNYRAT E ORGANIZIMIT TË TIJ

Për nevojat e FSK-së për bashkëpunim në situata emergjence dhe për mënyrat e organizimit të këtij bashkëpunimi, ekziston dhe është funksional një dokumenti i Qeverisë së Republikës së Kosovës i miratuar në maj 2010 për formimin e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME), i cili e parasheh qartë bashkëpunimin institucional në menaxhimin e emergjencave, qofshin ato në rrafshin lokal apo kombëtar.

Sistemi i integruar i menaxhimit të emergjencave portretizon ndërveprimin. Ai përafron procesin e ndarjes së përgjegjësive dhe detyrave në nivelin strategjik e operacional, duke siguruar një komunikim dhe informim të ndërsjellë ndërkombëtar. Ky sistem kërkon menaxhim të standardizuar të resurseve të cilat mundësojnë koordinim midis juridiksioneve dhe organizmave të ndryshme shtetërore e ndërshtetërore;

Ka shumë rëndësi që sistemi i integruar i menaxhimit të emergjencave të sigurojë mundësitë e veprimit të strukturave standarde organizative, gjë që është kritike në lejimin e organizatave dhe agjencive të ndryshme të punojnë së bashku në formën e koordinimit të paraparë. Nëpërmjet sistemit të integruar të menaxhimit të emergjencave duhet të arrijmë të integrojmë praktikën më të mira ekzistuese në një qasje të qëndrueshme, gjithëkombëtare, sistematike në menaxhimin e operacioneve të emergjencave, si ne ato vendore edhe ndërkombëtare.¹²⁰

Koordinimi ndër-institucional është proces i cili i mundëson të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjitha disiplinave të punojnë së bashku, në mënyrë më efektive dhe më efikase. Koordinimi ndër-institucional ndodh

¹¹⁷ Republika e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, f. 5-6

¹¹⁸ Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, f. 26

¹¹⁹ Republika e Kosovës/Kuvendi, Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Prishtinë, mars 2008, f. 5.

¹²⁰ Lama, Kudusi, Menaxhimi i Emergjencave Ndërkombëtare, Ligjëratat e autorizuar, Kolegji "Biznesi", Prishtinë 2013

nëpër disiplina të ndryshme të përfshira në menaxhimin e incidentit ,në për linja juridiksionale apo nëpër nivele të qeverisjes.

Koordinimi ndër-institucional mundet dhe ndodh në baza të rregullta sa here që personeli nga agjencitë e ndryshme ndërvepron në aktivitetet e tilla si gatishmëria, parandalimi, reagimi , rimëkëmbja dhe zbutja e rreziqeve . Në të shumtën e rasteve , agjencitë bashkëpunuese vendosin për Sistemin e Kordinimit Ndër - Institucional (SKNI), për të përcaktuar më mirë se si do të punojnë së bashku dhe si të funksionojnë në mënyrë më efektive; megjithëse koordinimi ndër-institucional mund të ndodh edhe pa vendosjen e protokolleve. SKNI-të mund të vihen në lëvizje pa marrë parasysh lokacionin , titujt e personelit apo strukturën organizative . SKNI-të përfshijnë resurse të planifikimit dhe koordinimit dhe mbështetjen tjetër për ngjarjet e planifikuara, të lajmëruara dhe të pa paraljmëruara . SKNI përcakton praktikën e punës , procedurat standard operative dhe protokollet për të cilave agjencitë pjesëmarrëse do t'i koordinojnë veprimet e tyre të ndërsjella . Elementet integrale të SKNI-së janë procedurat dhe protokollet e dispeqerisë, struktura e komandës së incidentit dhe aktivitetet e koordinimit dhe mbështetjes që zënë vend në një QOE të aktivizuar . Përfundimisht, SKNI siguron mbështetje ,koordinim dhe asistencë në vendimet e nivelit politik për strukturën SKI- së e cila menaxhon një incident.

Marrëveshjet e shkruara i mundësojnë agjencive brenda sistemit të zhvillojnë aktivitetet me përdorimin e rregullave të caktuara dhe shpeshherë janë të vet- përcaktuara nga organizatat pjesëmarrëse. SKNI i implementuar plotësisht është kritik për aktivitet të lehtë ,të koordinimit ndër-institucional dhe esencial për suksesin dhe sigurinë e reagimit. Për mëteper , përdorimi i SKNI-së është një nga komponentët fundamental të komandës dhe menaxhmentit brenda SIME-së, përderisa promovon shkallëzimin dhe fleksibilitetin të domosdoshme për reagim të koordinuar¹²¹.

Në mënyrë që një operacion i emergjencave të ketë një zhvillim dhe përfundim të suksesshëm, të gjithë aktorët e përfshirë në këtë operacion, duhet të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, dhe secili institucion (në rastin tonë FSK-ja) të kryejë detyrat e parapara me aktet ligjore në fuqi.

9. MËNYRAT E ORGANIZIMIT TË OPERACIONEVE TË EMERGJENCAVE NGA FSK

Mënyrat e organizimit të operacioneve të emergjencave nga FSK-ja, zhvillohen në bazë të një kronologjie të paracaktuar , duke shtuar këtu veçuritë që mund ta dallojnë një operacion të emergjencave.

Hapat që duhet të ndiqen në zhvillimin e një operacioni emergjent, janë të tilla:

- **Situata:** Fillimisht bëhet e qartë situata ku ndo të kryhet operacioni, tregohen në detaje të gjitha parametrat që e paraqesin këtë situatë..
- **Misioni:** Bëhet i qartë misioni të cilën do ta ndërmarrë FSK-ja në këtë operacion të emergjencave.
- **Operacionet që do të kryejnë trupat e FSK-së:**Tregohen detyrat dhe veprimet që do të kenë trupat apo njësitë e FSK-së në këtë operacion të emergjencave.
- **Planifikim dhe Përgatitja:**Këtu fillimisht vihen në pah *përparësitë* që mund të këtë operacioni:Alarmimi,gatishmëriadhe arrijtae pjesëtarëve me kohë në Kazerinë; Përgatitja dhe nisja e njësisësëKërkim Shpëtimit që të bëhet me kohë; Vetiniciativa

10. TRAJNIMET QË ORGANIZOHEN DHE ZHVILLOHEN NË FSK PËR PËRBALLIMIN E SITUATAVE TË EMERGJENCAVE

Gjatë vitit 2013, FSK-ja me qëllim të përgatitjes operative të njësiteve për ushtrimin fushor "Shqiponja2", FSK ka mbajtur një ushtrim në vendkomandë , në nivel të KFT-së ,si dhe UVK për stafin e Ministrisë pas ushtrimit fushor. Bazuar në objektivat e ministrit dhe direktivën e KOMFSK ,me qëllim të mbajtjes së gatishmërisë së FSK-së është realizuar ushtrimi fushor „Shqiponja2”, në fund të muajit shtator dhe fillim të muajit tetor 2013 ,në nivel të KFT-së. Qëllimi i këtij ushtrimi ka qenë verifikimi i aftësive dhe kapaciteteve operative të FSK-së. Gjithashtu gjatë vitit janë realizuar edhe shumë UF në nivel brigade dhe batalioni:

Foto më poshtë, demonstroi një trajnim të realizuar në terren malor (KSH-Male) dhe Figura nr. 4 një trajnim të realizuar nga skuadra e zjarrfikësve të FSK-së. Paraqitja e këtyre trajnimeve të lë të kuptosh më qartë mënyrën se si realizohen këto trajnime.

¹²¹ Qeveria e Republikës së Kosovës, Sistemi Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë, maj 2010, f. 65.

Figura nr. 1¹²²



Burimi: Dokumentit Prezantues të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, Regjimentit të Mbrojtjes Civile.

Figura nr. 2¹²³



Burimi: Dokumentit Prezantues të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, Regjimentit të Mbrojtjes Civile.

11. PRAKTIKA PLANIFIKUESE, DREJTUESE DHE E MENAXHIMIT TË OPERACIONEVE

Praktika planifikuese, drejtuese dhe e menaxhimit të operacioneve kanë treguar në vazhdimësi se përveç të arriturave të vazhdueshme që ka pasur FSK-ja në menaxhimin e emergjencave, duhet të punohet më shumë në drejtim të planifikimit dhe të menaxhimit. Serioziteti me të cilin i është qasur FSK-ja këtyre çështjeve ka bërë që të marrë vlerësime pozitive në këtë drejtim.

Viti 2013 mund të shihet si vit i progresit të konsiderueshëm të FSK-së, sepse më 9 korrik NATO-ja ka deklaruar Kapacitetet e Plota Operacionale (KPO) për Forcën e Sigurisë së Kosovës. KPO-të e deklaruar jo vetëm që konfirmojnë se FSK-ja është plotësisht e aftë për kryerjen e misionëve të saja kryesore në mënyrë profesionale dhe të pavarur, por gjithashtu kjo ngjarje e hap një kapitull të ri për zhvillimin e mëtutjeshëm të forcës. Ky është rezultat i punës së përkushtuar, që nga dita e parë e themelimit të FSK-së.

Viti 2013 ka kaluar në organizimin e detajuar të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Ky është një proces gjithëpërfshirës dhe i hollësishëm, i cili analizon në tërësi sektorin e sigurisë në Kosovë dhe përcakton kapacitetet që janë të nevojshme për t'u garantuar siguria e shtetit tonë në të ardhmen. Pjesëtarët e FSK-së kanë marrë pjesë në një varg ushtrimesh fushore në rajon, të cilat kanë përqëllim fuqizimin e bashkëpunimit në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor, në reagim ndaj emergjencave dhe menaxhimit të krizave. Popujt tonë në rajon janë të vegjël, kështu që është shumë më rëndësi t'i rrisim përpjekjet dhe kapacitetet tona duke punuar dhe vepruar së bashku. FSK-ja është shumë e përkushtuar që të jetë një forcë e besueshme, e dobishme dhe e aftë, në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe e gatshme të jap kontribut të konsiderueshëm në sigurinë rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. Në zhvillimin tonë të mëtutjeshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë me mëmiqtë dhe partneret tanë të cilëve u jemi mirënjohës për mbështetjen, këshillimin dhe ekspertizën e ofruar. Ne kemi shumë arsye për të cilat duhet krenuar, ndonëse ende ka shumë për t'u bërë. Dua ta përsërisë edhe njëherë se qëllimi ynë mbetet i njëjtë, ne po e zhvillojmë FSK-në si forcë

¹²² Brigada e Mbështetjes Operacionale / Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Dokument Prezantues, dhjetor 2013, f. 9

¹²³ Po aty, f. 10

për të mire , e cila ofron mbështetje për të gjithë qytetarët e shtetit tone dhe e gatshme për të ndihmuar të gjithë ata që kanë nevojë, në nivelin shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar.”¹²⁴

Përvojat e përfituara nga FSK-ja gjatë zhvillimit të operacioneve të ndryshme të emergjencave kanë bërë që ajo të jetë më e kujdeshme dhe të paraqesë objektiva të qarta për përmirësimin e punës dhe të performancës së saj.

Objektivi I – Të bëhet FSK-ja e vetëqëndrueshme dhe të vazhdojë të zhvillojë kapacitetet operacionale – duke pasur kujdes në ruajtjen dhe zgjerimin e këtyre kapaciteteve.

Objektivnr.2- Bërja e FSK-së force e besueshme , e aftë , active dhe e dallueshme për të mirë , duke: respektuar të drejtat e njeriut dhe barazigjinore , përkrahur autoritetet civile dhe komunitetet, Mbështetur komuniteteve dhe OJQ.

Objektivnr.3- Bërja e FSK-së “force për të mirë” në regjion , nëpërmjet : aktiviteteve ushtarake rajonale dhe ndërkombëtare ; Anëtarësimin e iniciativat regjionale për siguri.

Objektivnr.4- Bërja e FSK-së force zbarkuese jashtë vendit

Objektivnr.5- Bërja e FSK-së një partner i përkushtuar i SHBA-ve , NATO-së dhe BE-së,

12. PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Kosova, si vend në zhvillim e sipër, ka nevojë për kapacitete më të përgatitura për të qenë në gjendje të reagojë në situatë krizash e që mund të jenë të natyrës së ndryshme. Rrezikimi i shoqërisë shikohet në mënyrë konkrete, jo vetëm si një kërcënim i zakonshëm që lidhet me llojet e ndryshme të incidenteve të rrezikshme, që nga ato të përditshmet (siguria rrugore, ndotja e mjedisit, etj.), por deri tek fatkeqësitë e mëdha, si përmbytjet, tërmetet apo katastrofat nga shpërthimet, përfshirë këtu edhe pasojat që vijnë nga aksidentet teknologjike apo veprimet terroriste.

Me rëndësi është përpilimi dhe ndërtimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të emergjencave. Ky sistem afion kornizë të qëndrueshme gjithëkombëtare për të mundësuar që qeveritë e të gjitha niveleve, organizatat joqeveritare dhe sektori privat, të punojnë së bashku për parandalimin, mbrojtjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zvogëlimin e efekteve të rreziqeve e kërcënimeve që mund të paraqesin fatkeqësi për jetën e njerëzve, pasurinë e tyre dhe mjedisin, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre. Kjo qëndrueshmëri ofron bazament për përdorimin e sistemit për të gjitha incidentet duke filluar nga ndodhitë e përditshme deri tek incidentet që kërkojnë reagim të koordinuar qeveritar¹²⁵.

Meqenëse roli i Forcave të Sigurisë së Kosovës në operacionet e emergjencave është mjaft i madh dhe përbën misionin kryesor të saj, atëher duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme ngritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve të saj si forcë mbrojtëse, dhe si forcë kryesore dhe mbështetëse në operacionet e emergjencave.

LITERATURA

- Lama, K., (2014) Menaxhimi i emergjencave është pjesë integrale e sigurisë së jetës, Referat i mbajtur në Konferencën Shkencore “Mbrojtja civile në shoqëri”, Prishtinë,
- Lama, K., (2013) Analiza dhe vlerësimi i rrezikut / Mungesa e strategjive dhe burimeve financiare, rrezik i vazhdueshëm për fatkeqësi që përbëjnë emergjencë, Kolegji “Biznesi”, Prishtinë
- Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes së Republikës së Kosovë, GAP – Instituti për Studime të Avancuara, Prishtinë,
- Forumi për Siguri, Sektori i Sigurisë në Kosovë pas Pavarësisë, Prishtinë, tetor 2010,
- Qeveria e Kosovës, Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë, maj 2010,
- Qeveria e Kosovës, Plani i Reagimit Kombëtar, Prishtinë, dhjetor 2010,
- Pakoja e Ahtisarit, Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës - Sektori i Sigurisë Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Qeveria e Republikës së Kosovës, Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Prishtinë, mars 2014,
- Ligji për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L045,
- Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
- Republika e Kosovës/Kuvendi, Ligji nr. 04/L-076 për Policinë,
- Ligji nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri;
- Ligji nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,
- Ligji për Kujdesin Shendetësor Emergjent Nr.2006/02-L50

¹²⁴ MFSK, Raporti vjetor 2013, Fjala e ministrit Agim Çeku, Prishtinë, publikuar më 23.12.2013, f. 5

¹²⁵ Lama, Kudusi, “Mundësitë dhe mënyrat e intergimit të Forcave të Emergjencave të Kosovës në menaxhimin e emergjencave ndërkombëtare”, Ligjërata të autorizuara, Kolegji “Biznesi”, Prishtinë, 2013